Numër: 01/363
Datë: 06.06.2024

Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve duke vendosur sipas ankesës Nr. 01/221 të parashtruar me datë 19.04.2024 nga Institucioni "Sellma Academy", me adresë: Magjistralja Prishtinë- Shkup, KM 3, 10500 Graçanicë, Kosovë, kundër vendimit të Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve Nr.01/151 të datës 15.03.2024, në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Bazuar në nenin 5 paragrafi 8 të Rregullores Nr. 01/196 së punës të Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 30.05.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa e institucionit "Sellma Academy" Nr. 01/221 e datës 19.04.2024, e ushtruar kundër vendimit të Këshillit Drejtues Nr. 01/151 të datës 15.03.2024.

II. Mbetet në fuqi vendimi Nr. 01/151, i datës 15.03.2024 i Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve.

III. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve duke u bazuar në kërkesën e institucionit "Sellma Academy" Nr.01/399, e datës 11.07.2023 për hyrje në proces të akreditimit dhe validimit për kualifikimin Grimer, niveli III i KKK, bazuar në raportin e zyrtarëve të AKK-së mbi gjendjen e aplikacionit të cilët kanë rekomanduar për Këshillin Drejtues aprovim të kërkesës si më lartë, Këshilli Drejtues i AKK-së në mbledhjen e mbajtur me datë 05.10.2023 ka aprovuar kërkesën e institucionit "Sellma Academy" për hyrje në proces të akreditimit dhe validimit. Pas aprovimit të kërkesës Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve ka vazhduar me procedurat tjera sipas legjislacionit në fuqi nga fushëveprimtaria e AKK-së. Zv. i Drejtorit të AKK-së gjatë komunikimeve në mes të zyrtares së AKK-së me përfaqësuesen e institucionit "Sellma Academy" me qëllim të realizimit të

vizitës së ekipit të ekspertëve tek pala ankuese ka kuptuar se pjesë e stafit ishte edhe z. Milot Hasangjekaj (ish zyrtar i AKK-së) dhe kishte kërkuar nga zyrtaret e AKK-së dosjen e aplikuesit me qëllim të vërtetimit nese z. Hasangjekaj ishte pjesë e stafit të "Sellma Academy".
Bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.35/2014 Kriteret dhe procedurat për validim dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, neni 10 paragrafi 1 pika 1.12. Institucioni aplikues duhet të ofroj kontratë ligjore të arritur me stafin për periudhë të caktuar, si dhe neni 11 paragrafi 1 pika 1.1 Faza 1: Institucionet marrin informata dhe udhëzime nga AKK dhe zhvillojnë një vetëvlerësim bazuar në kriteret e AKK. Institucioni e paraqet aplikacionin, raportin e vetëvlerësimit dhe dokumentacionet tjera shtesë duke u bazuar në kriteret e përcaktuara nga AKK. Ndërsa, institucioni "Sellma Academy" në listën e stafit menaxhues, profesional dhe administrativ të dërguar në AKK ka caktuar z. Hasangjekaj si pjesë e stafit, mirëpo në dosjen e aplikimit ka munguar kontrata dhe CV-ja e tij, duke mos përmbushur kriteret e përcaktuara nga AKK sipas dispozitave ligjore në fuqi. Gjithashtu, është vërejtur se në dosje ka edhe parregullsi tjera sa i përket periudhës kohore kur janë nënshkruar aneks kontratat e pjesës tjetër të stafit të ofruesit, të cilat bazuar në provat e administruara janë nënshkruar me datë 01.09.2023, ndërsa institucioni ka aplikuar në AKK me datë 11.07.2023. Lidhur më këtë zv. Drejtori i AKK-së me datë 21.12.2023 përmes email-it ka kërkuar sqarim nga zyrtarja e AKK-së, se a është plotësuar dosja e aplikimit me ndonjë material tjetër pas dorëzimit të aplikimit, nese po me çfarë materiali dhe kur? Zyrtarja e AKK-së përmes email-it me datë 22.12.2023 ka ofruar këto të dhëna: Me datë 11.07.2023, "Sellma Academy" ka sjellur kërkesën bashkë me dosjen aplikuese për hyrje në proces, dosja e aplikimit nuk është plotësuar me material shtesë. Prandaj, Këshilli Drejtues në mbledhjen e datës 05.10.2023 ka aprovuar raportin e eksperteve të brendshëm të AKK-së pas rekomandimeve se aplikacioni i plotëson kushtet bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, pa qenë në dije se dosja e aplikuesit ka mangësi dhe se e njëjta nuk është plotësuar bazuar në kriteret e përcaktuara në Udhëzimin Administrativ Nr.35/2014 Kriteret dhe procedurat për validim dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë.

Këshilli Drejtues i AKK-së bazuar në kompetencat e tij ligjore, vërtetimit të gjendjes faktik dhe analizimit të provave të ofruar nga zv. i Drejtorit të AKK-së, me datë 15.03.2024 ka nxjerr vendimin Nr. 01/151 me të cilin ka anuluar vendimin e KD-së të AKK-së për aprovim të kërkesës së institucionit "Sellma Academy" për hyrje në proces të akreditimit dhe validimit të marrë në mbledhjen e datës 05.10.2023.

Institucioni "Sellma Academy" është njoftuar lidhur me vendimin e Këshillit Drejtues të AKK-së me datë 20.03.2024, ndërsa vendimin në formë fizike e ka pranuar me datë 28.03.2024.

Institucioni "Sellma Academy" i pakënaqur me vendim Nr. 01/151, të datës 15.03.2024 të Këshillit Drejtues të AKK-së, me datë 19.04.2024 brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë pranë Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve e cila është protokolluar dhe ka marrë Nr.01/221, me pretendimet e aplikimit të gabuar dhe jo të drejtë të legjislacionit në fuqi, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, shkeljes së Ligjit Nr. 05/ L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe shkeljes së dispozitave të Rregullores Nr. 01/521 për përcaktimin e Procedurave për Aplikim të Institucioneve të Arsimit dhe Aftësimit profesional, për akreditim institucional, validim dhe aprovim të kualifikimeve sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe për aplikim të institucioneve që zbatojnë Njohjen e Mësimit Paraprak.

Administrimi i provave: Këshilli Drejtues i AKK-së me rastin e marrjes së vendimit meritor administroj këto prova:

- Vendimin Nr. 01/151, i datës 15.03.2024, i Këshillit Drejtues të AKK-së;
- Ankesën e Institucionit "Sellma Academy" Nr. 01/221, e datës 19.04.2024;
- Kërkesën e Institucionit "Sellma Academy" drejtuar KD të AKK-së, e datës 11.07.2023;
- Njoftimi i AKK-së për caktimin e procesit të vizitës me datë 16.11.2023;
- Fatura për pagesën e realizuar tek AKK me datë 23.11.2023;
- Procesverbali i mbledhjes së KD-së i datës 30.11.2024;
- Email-i i zv. të Drejtorit të AKK-së datë 14, 16 dhe 22. 03.2023, me znj. Adelina Kasumoviq;
- Përgjigja (opinioni) i APK i datës 04.12.2023;
- Shkeresa e z. Milot Hasanxhekaj drejtuar KD të AKK-së e dt. 31.12. 2023;
- Marrëveshja mes Sellma Academy dhe Bizz CO LLC;
- Udhëzues i AKK për ofruesit;
- Lista e Kontrollit për ofrimin e dokumenteve të nevojshme për proces të akreditimit dhe validimit nga AKK për institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional për IAAP "Sellma Academy" e përpiluar nga stafi i AKK me 25.09.2023;
- Lista e stafit menaxhues, profesional dhe administrativ të "Sellma Academy" e bashkangjitur në dosjen e aplikimit;
- Kontratat dhe aneks kontratat me stafin nga Dosja e aplikimit e institucionit "Sellma Academy";
- Raportin e zv. të Drejtorit të AKK-së me sqarime lidhur me rastin e ofruesit/institucionit "Sellma Academy" i datës 18.01.2024;
- Emali i datës 21.12.2023, i zv. të Drejtorit të AKK-së drejtuar zyrtares të AKK-së lidhur me ofrimin e sqarimeve shtesë;
- Emali e datës 14.12.2023 nga zv. i Drejtorit të AKK-së drejtuar znj. Adelina Kasumoviq;
- Emali i datës 15.12.2023 i znj. Adelina Kasumoviq;
- Emali i datës 26.12.2023 nga zv. i Drejtorit të AKK-së drejtuar znj. Adelina Kasumoviq;
- Emali i datës 27.12.2023 nga znj. Adelina Kasumoviq;
- Marrëveshja për bashkpunim Afarist e datës 10.07.2023 mes 'Sellma Beauty" SH.P.K dhe Bizzco L.L.C përfaqësuar nga z. Milot Hasangjekaj.

Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankesa e ushtruar nga Institucioni "Sellma Academy" është e pa bazuar sepse:

Pala ankuese pretendon se vendimin e KD të AKK- së e ka pranuar me datë 28.03.2024 dhe në këtë ditë është njoftuar për vendimin. Ky pretendim nuk qëndron sepse Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve përmes email-it zyrtar me datë 20.03.2024 e ka njoftuar institucionin se vendimi i KD-së i marrë me datë 15.03.2024 është gati dhe mund të vini në zyrat e AKK-së për ta tërhequr vendimin, mirëpo institucioni vendimin e ka tërhequr me datë 28.03.2024.

Pala ankuese pas kërkesës për sqarime shtesë nga zv. i drejtorit të AKK-së rreth rolit të z. Milot Hasangjekaj në Institucionin "Sellma Academy" pretendon se ka sqaruar se z. Hasangjekaj nuk është staf i "|Sellma Academy" por ofrues i shërbimeve profesionale. Këshilli Drejtues i AKK-së konstatoj se pretendimi i palës ankuese është i pa bazuar për faktin se institucioni në dosjen e aplikimit të dorëzuar në AKK me datë 11.07.2023, ka bashkangjitur listen e stafit menaxhues, profesional dhe administrativ të "Sellma Academy" në të cilën z. Hasangjekaj mban pozitën e Udhëheqësit të trajnimeve dhe sigurimit të cilësisë. Andaj, bazuar në nenin 10 paragrafi 1 pika 1.12 e Udhëzimit Administrativ Nr.35/2014 Kriteret dhe procedurat për validim dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Institucioni aplikues ka qenë i obliguar të ofroj kontratë ligjore të arritur me stafin për periudhë të caktuar, ndërsa në dosjen e aplikimit ka munguar kontrata dhe CV-ja e z. Milot Hasangjekaj. Institucioni "Sellma Academy" vetëm pas kërkesave përmes emal-it nga zv. i Drejtorit të AKK-së ka ofruar Marrëveshjen për Bashkëpunim Afarist të lidhur me datë 10.07.2023 në mes "Sellma Beauty" Sh.p.k dhe Bizzoco L.L.C. të përfaqësuar nga z. Milot Hasangjekaj, ku në nenin 1 të kësaj marrëveshje ndër të tjera theksohet se z. Hasangjekaj do të jetë udhëheqës i sigurimit të cilësisë dhe i trajnimeve që marrësi i shërbimit (Sellma Academy) do ti ofroj pas procesit të akreditimit dhe validimit nga Autoritetit Kombëtar i Kualifikimeve. Andaj, pretendimi i palës ankuese se z. Hasangjekaj nuk është stafi i institucionit "Sellma Academy" është i pa bazuar.

Pala ankuese konteston vendimin e Këshillit Drejtues të AKK-së Nr. 01/151, të datës 15.03.2024, me pretendimin se vendimi i KD i AKK-së i datës 05.10.2023 me të cilin është aprovuar kërkesa e palës aplikuese për hyrje në proces të akreditimit dhe validimit nuk ka qenë një akt administrativ në formen e strukturuar dhe elementet e kërkuara në dispozitat e nenit 47 të Ligjit për Proceduren e Përgjithshme Administrative dhe si përfundim nuk ka qenë një vendim. KD hodhi posht këtë pretendim pasi bazuar në nenin 46 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Proceduren e Përgjithshme Administrative : përveq kur parashikohet ndryshe me ligj, akti administrativ nxirret në formë të shkruar, verbale apo në çdo formë tjetër të përshtatshme, përfshir shenja dhe mjete tjera teknik. Aprovimi i kërkesës së institucionit "Sellma Academy" për hyrje në proces të akreditimit dhe validimit dëshmohet përmes procesverbalit të mbledhjes së datës 05.10.2023 të Këshillit Drejtues.

Pala ankuese pretendon se vendimi i ankimuar është nxjerrë në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1 të LPPA i cili përcakton se: Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca, duke pretenduar se Këshilli Drejtues i AKK-së ka vepruar në kundërshtim me Rregulloren Nr. 01/521 të datës 01.12.2020 për përcaktimin e procedurave për aplikimin e institucioneve të Arsimit dhe Aftësimit profesional, për akreditim institucional, validim dhe aprovim të kualifikimeve sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe për aplikim të institucioneve që zbatojnë Njohjen e Mësimit Paraprak, përkatësisht nenin 7 paragrafi 9 i cili përcakton se: Në rast se Këshilli Drejtues i AKK-së merr vendim për aprovim të aplikacionit, atëherë ky i fundit autorizon Drejtorin e AKK-së për vazhdimin e procedurave të matutjeshme të procesit, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi. Pala ankuese pretendon se në asnjë nen të kësaj rregulloreje nuk përcaktohet që KD i AKK-së ka të drejtë që të rishqyrtojë aplikacionin ose të marrë vendim tjetër lidhur me aplikacionin ose kërkesën e IAAP pas aprovimit.

Këshilli Drejtues hodhi posht këtë pretendim të palës ankuese për faktin se KD është organ Kolegjial dhe bazuar në nenin 53 paragrafi 1 i Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme

Administrative, një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyres zyrtare, nga organi publik që ka kompetenc të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj, në këto rrethana Këshilli Drejtues ka vepruar brenda kompetencave ligjore, pas raportimit të zv. të Drejtorit të AKK-së se në dosjen e aplikimit të palës ankuese mungon kontrata dhe CV-ja e z. Milot Hasangjakaj i cili bazuar në dokumentet e ofruar nga pala ankuese mban poziten e udhëheqësit të trajnimeve dhe sigurimit të cilësisë, rrethan kjo e cila nuk është paraqitur në Listen e kontrollit për dokumentet e nevojshme për procesin e akreditimit dhe validimit nga AKK për Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional, mbi bazën e të cilës KD ka aprovuar kërkesën e institucionit "Sellma Academy" për hyrje në proces të akreditimit dhe validimit.

Këshilli Drejtues ka hedhur posht pretendimin e palës ankuese se nuk është vërtetuar drejt gjendja faktike me rastin e marrjes së vendimit të kontestuar, për faktin se KD me rastin e vendosjes kishte analizuar të gjitha provat e ofruara nga zv. i Drejtorit të AKK, prova këto që kanë dëshmuar qartë se institucioni nuk e ka plotësuar dosjen e aplikimin bazuar në kriteret dhe standardet e përcaktuara në Udhëzimin Adminsitrativ Nr.35/2014 Kriteret dhe procedurat për validim dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, duke shkelur nenin 10 paragrafi 1 pika 1.12 i cili përcakton: institucioni aplikues duhet të ofroj kontratë ligjore të arritur me stafin për periudhën e caktuar. Ndërsa çeshtja e sqarimit të konfliktit mundshëm të interesit e ngritur nga zv. Drejtori i AKK-së, në Agjencin për Parandalimin e Korrupsionit nuk ka qenë rrethan e cila ka ndikuar në marrjen e vendimit të kontestuar.

Institucioni "Sellma Academy" me rastin e parashtrimit të ankesës pretendon se me rastin e marrjes së vendimit të kontestuar zv. i Drejtorit të AKK dhe Këshilli Drejtues kanë vepruar në kundërshtim me nenin 94 të LPPA-së, i cili përcakton se: pala në çdo fazë të procedurës, ka të drejt të paraqes mendime, shpjegime për faktet, rrethanat apo çështjet ligjore, që kanë të bëjnë me procedurën përkatëse, së bashku me provat e dokumentet përkatëse në të cilat i mbështetë ato si dhe të paraqes propozime për zgjidhjen e çështjes. Pala ankuese pretendon se vendimi i kontestuar është në kundërshtim me nenin 6 paragrafi 2 të LPPA i cili përcakton se: "Përsonat në të njëjtën situatë trajtohen në mënyrë të njëjtë. Dallimi në trajtimin e çeshtjeve justifikohet vetëm nëse dhe për aq sa ai përputhet me ndryshimet objektive të çeshtjeve përkatëse", me arsyetimin se AKK e ka dalluar palën ankuese duke vepruar ndryshe, për dallim nga IAAP tjera, të cilave i është lejuar plotësimi dhe ofrimi i informacioneve shtesë për aplikacionin, pa pasur nevojë që aplikacioni të ri diskutohet në KD të AKK.

Këshilli Drejtues hodhi posht si të pa bazuara këto pretendime sepse dosja e aplikimit fillimisht është dorëzuar e pa kompletuar dhe si e tillë është miratuar nga ana e Këshillit Drejtues të AKK-së, pas rekomandimeve të ekspertëve të brendshëm të AKK-së për aprovim të dosjes, e pa qenë në dijeni se mungon kontrata dhe CV-ja e z. Hasangjekaj i cili nga ana e ofruesit "Sellma Academy" ishte listuar si pjesë e stafit, dhe atë në poziten udhëheqës i trajnimeve dhe sigurimit të cilësisë. Pala ankuese në fazen para aplikimit ka qenë e njoftuar me Rregulloren Nr. 01/521, të datë 15.12.2020 për përcaktimin e procedurave për aplikimin e institucioneve të Arsimit dhe Aftësimit Profesional, për akreditim institucional, validim dhe aprovim të kualifikimeve sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe për aplikim të institucioneve që zbatojnë Njohjen e Mësimit Paraprak, ku neni 5 përcakton qartë se: të gjitha IAAP-të të cilat shprehin interesin për të aplikuar në AKK, për akreditim institucional, validim dhe aprovimin e kualifikimeve, apo akreditim të institucioneve që zbatojnë njohjen e mësimit paraprak, duhet që dosjen e tyre të aplikimit ta hartojn

në përputhje me dispozitat ligjore, udhëzimet administrative, standardet dhe kriteret e vendosura nga AKK.

Këshilli Drejtues i AKK-së me rastin e vendosjes në ankesë është mbështetur në dispozitat ligjore të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr.35/2014 kriteret dhe procedurat për validim dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Rregulloren Nr.01/521, të datë 15.12.2020 për përcaktimin e procedurave për aplikimin e institucioneve të Arsimit dhe Aftësimit profesional, për akreditim institucional, validim dhe aprovim të kualifikimeve sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe për aplikim të institucioneve që zbatojnë Njohjen e Mësimit Paraprak, Rregulloren e Këshillit Drejtues të AKK-së Nr.01/196 e dt. 25.05.2021, si dhe Ligjin për Procedurën e përgjithshme Administrative.

Nga të lart cekurat Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj padi në Gjykatën Kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Hapja e Konfliktit Administrativ nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:
1. Institucionit "Sellma Academy"
2. Arkivit të AKK-së

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK-së